

Përmbledhje e Minutave të Mbledhjes

KËSHILLI I INVESTIMEVE, MBLEDHJA IV

27 Prill 2016, ora 17:00 – 19:00

Tiranë, 27 Prill 2016

Mbledhja u mbajt në ambjentet e Tirana Business Park, kryesuar nga Znj. Milva Ekonomi, Ministër i MZHETTS.

I. Hapja e Mbledhjes

Kryetarja e Këshillit të Investimeve, Ministria Milva Ekonomi mirëpriti pjesëmarrësit dhe hapi mbledhjen duke vënë në dukje që zyrat e reja të Agjencisë Kombëtare për Zhvillimin e Investimeve (AIDA) tashmë janë pranë ambjenteve të Tirana Business Park. Tashmë, AIDA perceptohet si një dritare e vetme për investitorët, për këtë arsye Kryetarja I kërkoi Anëtarëve të Këshillit dhe Shoqatave që të shpërndanin informacionin mbi vendodhjen dhe rolin e ri të AIDA-s. Qëllimi I kësaj mbledhjeje nuk ishte vetëm krahasimi i ecurisë së investimeve të Shqipërisë nga viti në vit, por gjithashtu për të krahasuar incentivat për investime të Shqipërisë krahasuar me vendet e tjera të rajonit të Ballkanit Perëndimor. Kryetarja shprehu mirënjohjen që është pjesë e Këshillit të Investimeve dhe falenderoi Këshillin për punën e kryer deri më tani.

II. Ecuria e Rekomandimeve të Mbledhjeve të Mëparshme

Drejtorja e Sekretariatit, Znj. Diana Leka informoi shkurtimisht mbi statusin dhe ecurinë e rekomandimeve nga mbledhjet e mëparshme të Këshillit të Investimeve. Në total janë miratuar nga Këshilli 29 rekomandime, disa prej të cilave kanë të bëjnë me aspektin ligjor të legjislacionit, transparencën dhe komunikimin. Katër rekomandime janë përmbushur ndërsa trembëdhjetë masa janë në proces diskutimi dhe vlerësimi. Sekretariati ka marrë informacion të konsoliduar nga Ministria e Financave, Administrata Tatimore, Administrata Doganore, etj. Disa nga veprimet kryesore në vazhdimësi nga ana e Qeverisë janë:

- *Mbi Kontrollin Tatimor:* rishikimi i manualit për kontrollin tatimor, ristrukturimi i Administratës Tatimore me fokus mbi inspektorët tatimorë, reduktimin e barrierave për apelimin administrativ, roli i Avokatit të Tatimpaguesve dhe roli i Drejtorisë së Apelimit Tatimor (DAT).
- *Mbi Informalitetin:* në përgatitje një plan i brendshëm me veprime dhe arritje duke synuar thjeshtimin e procedurave dhe lançimin nga Ministria e Financave në fazën e dytë të “aksionit kundër informalitetit”.

III. Gjetjet Kryesore mbi Incentivat për Nxitjen e Investimeve, Shqipëria krahasuar me Vendet e Ballkanit Perëndimor

Drejtoresha e Sekretariatit, Znj. Diana Leka prezantoi shtyllat kryesore të analizës kryer nga Sekretariati, duke u fokusuar mbi kontekstin, metodologjinë, dhe së fundmi mbi gjetjet kryesore dhe rekomandimet e rezultuara nga konsultimi i ngushtë me komunitetin e biznesit. Në vijim, Z. Genti Beqiri, Kreu i AIDA-s, dha një prezantim të shkurtër mbi investimet në Shqipëri dhe zbatimin e ligjit mbi investimet strategjike duke paraqitur katër projekte konkrete për status të veçantë sikurse parashikuar nga ligji.

Të përmbledhura në vijim, komentet kryesore që u adresuan gjatë Mbledhjes:

- Znj. Ermonela Felaj, Ministër i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin (MSMP), ofroi informacion shtesë mbi zbatimin e Rekomandimeve të Këshillit të Investimeve, duke ndarë disa veprime të MSMP dhe Qeverisë për të adoptuar këto rekomandime. Në mënyrë specifike, Ministria Felaj bëri referencë me ndryshimin në lidhje me parapagimit të detyrimit tatimor dhe doganor si një kërkesë për kompanitë apeluese, detyrimin për pranimin e vendimeve të DAT, etj. MSMP është duke bashkëpunuar me Ministrinë e Financave për të përfshirë disa rekomandime të Këshillit të Investimeve tek Ligji për Proçedurat Tatimore. Por, Ligji për Proçedurat Tatimore është ende në shqyrtim nga Gjykata Kushtetuese, dhe vendimi nga kjo Gjykatë nuk ka dalë ende; prandaj, momentalisht është e pamundur që të procedohet me ndryshime konkrete sipas rekomandimeve të Këshillit të Investimeve. Në lidhje me Ligjin mbi Falimentimin mbështetur nga IFC, MSMP është duke ndjekur ngushtë ecurinë e miratimit të tij, gjë të nuk ka përfunduar ende për arsye teknike. Në të njëjtën kohë, Ministria e Drejtësisë kërkon ndryshimin e Kodit të Proçedurave Civile, i cila ka lidhje me Ligjin mbi Falimentimin, por që kërkon për miratim votim me shumicë kualifikuese nga Parlamenti. Rrjedhimisht, fillimisht nevojitet të miratohen ndryshimet për Kodin, dhe më pas do të kalohet për miratimin e Ligjit mbi Falimentimin. Në lidhje me rekomandimet e Këshillit të Investimeve për zbatimin e duhur të Ligjit mbi Konsultimin Publik, MSMP së bashku me Ministrinë e Inovacionit do të propozojnë një rregullore të brendshme për Qeverinë në mënyrë që t'i kërkohej institucioneve qendrore gjatë hartimit të një akti, konsultimin faktik me palë të interesuara jo vetëm në shifra por edhe në cilësi.
- Z. Luan Muça, Delta Group, theksoi rëndësinë e Projektit të Trans Adriatik (TAP) i cili pritet të përfundojë në vitin 2020, dhe përfitimet e mundshme që do t'i sjellë ky project sektorit privat në Shqipëri. Shqetësimi i tij kryesor kishte të bënte nëse Qeveria ka filluar tashmë zbatimin e projekteve konkrete për shpërndarjen e gazit në vitin 2020, pasi një nga elementët kryesore për të pasur një industri të fortë është aksesimi në burime të lira energjie si gazi. Në lidhje me Zonën e Tregtisë së Lirë të Porto Romano në Durrës, shumë e dobishme për biznesin, Z. Muça mendon se nevojitet të ushtrohet një shtysë për monitorimin dhe kushtet e bizneseve vendase operuese në këtë zonë.

- Z. Dritan Nako, Antea Cement, ndau shqetësimin në lidhje me mungesën e konkurrueshmërisë së produkteve vendase në industrinë e çimentos, kryesisht për shkak të barrës së pajustificueshme fiskale rezultuar që nga viti 2012 me një tarifë shtesë për materialet e djegshme të përdorura gjatë procesit industrial. Për këtë rast të veçantë, modeli i BE parashikon një përjashtim nga taksat. Ndërsa në Shqipëria situata aktuale ka rritur koston e produkteve vendase, të cilat arrijnë një vlerë eksportuese prej 40-50 milion EUR, duke siguruar 1,000 vende pune në vend, ka shkaktuar shumë disavantazh krahasuar me produktet e importuara por gjithashtu edhe pamundësi për të eksportuar në tregje të huaja. Gjithashtu, kjo situatë nuk lehtësohet nga bllokimi i Ligjit mbi Importin e Mbetjeve sikurse edhe kushtet jo të duhura të infrastrukturës, si psh rasti i Portit të Durrësit i cili nuk ka thellësinë e duhur për të sjellë anije me tonazh të madh për të arritur në destinacione të largëta përtej rajonit. Kompania ANTEA Cement shpreh gatishmërinë për të ndarë disa propozime konkrete mbi këto çështje me Këshillit e Investimeve si dhe me Ministrinë e Ekonomisë, sikurse ndarë me institucione të tjera publike.
- Z. Silvio Pedrazzi, FIAA, shprehu vlerësimin për analizën pasi tashmë mund të ndajmë faktet nga dukja, sikurse kërkuar shumë herë nga Kryeministri. Bazuar nga të dhënat e analizës, mesa duket barra tatimore nuk duket të jetë një çëshje për tërheqjen e investimeve të huaja në vend. Është e nevojshme të vendoset një konsistencë në politikë-bërje. Prandaj, është e nevojshme që të fuqizohet AIDA me burimet e duhura, njerëzit e duhur, pasi ekziston një nevojë e vërtetë për të gjurmuar kompanitë e huaja të cilat mund të përfitojnë nga avantazhet e ofruara nga Shqipëria.
- Z. Yngve Engstroem, Delegacioni i BE, vuri në dukje se krahasimet janë të dobishme për të kuptuar mjediset e biznesit por në anën tjetër përfaqësues së biznesit, sidomos atij të huaj, nuk janë të interesuar kryesisht mbi incentivat. Është e vërtetë që Shqipëria shihet si vend tërheqës, pasi ka potenciale në agrobujqësi dhe industrinë e ushqimit, në energji, dhe shumë avantazhe të tjera natyrore. Në anën tjetër, Shqipëria duhet të vendosë disa kushte themeltare. Duhet të vendoset mbi Reformën në Drejtësi në mënyrë që mos të ketë pengesa për tërheqjen e investimeve. Gjithashtu, Z. Engrstroem theksoi rëndësinë për të promovuar dhe shfrytëzuar disa programe mbështetjeje dhe produkte financiare si incentiva për sektorin privat të hartuara nga BE në bashkëpunim me organizata të tjera si BERZH, EIB, KfW. Këshilli i Investimeve mund të jetë një platformë e mirë për të bërë të njohura këto programe.
- Z. Christoph Denk, Zyra e BERZH-it në Tiranë, u shpreh dakord me komentimin e bërë nga Z. Muça në kuadër të projektit TAP për të ecur sa më shpejt në mënyrë që të bëhet e disponueshme infrastruktura e gazit në Shqipëri, si një avantazh për sektorin publik dhe privat në Shqipëri. Varet nga Qeveria se si kjo mund të sillet brenda vitit 2020, gjithashtu edhe me asistencën e donatorëve. Në lidhje me IHD-të, është e rëndësishme, veçanërisht për Shqipërinë, për të parë përtej statistikave, dhe ka

fusha ku mund të punohet, veçanërisht në sektorin e naftës dhe gazit ku IHD-të kanë qenë të fokusuar në të shkuarën. Është e rëndësishme që të shihet përtej sektorëve dhe zgjerohen industritë e IHD-ve, pasi ka shumë sektorë të tjerë me avantazhe natyrore. Shqipëria mund të tërheqë industri me punë intensive sikurse ajo automotive dhe të shfrytëzojë koston e ulët të punës, pozicionin gjeografik, etj. Ka investitorë në industrinë automotive me punë intensive të interesuar për të investuar dhe interesi i Qeverisë për këtë është më i madh nga sa pritej. Për shembull, industria përpunuese është një nga proceset që mund të kualifikohet si investim strategjik për procedurë të përshpejtuar. Në lidhje me fondin e garancisë për sektorin privat ofruar nga BERZH, Z. Denk sqaroi që ekzistojnë ende disa procedura të brendshme të BERZH dhe me bankat e kontraktuara për t'u ndjekur dhe shpresohet që të hyjë në funksion në javët e ardhshme.

- Z. Nikolin Jaka, Kryetar i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë së Tiranës, përgëzoi punën dhe analizën e kryer nga Sekretariati, me mbështetjen e BERZH-it. Z. Jaka pohoi se Shqipëria duhet të ketë një paketë tërheqëse për investitorët e huaj dhe vendas, por në anën tjetër duhet të ekzistojë një orientim territorial për t'i asistuar qartazi investitorët dhe për t'i bindur që paratë e investuara do t'ju kthehen. Është bërë e domosdoshme që menaxhimi territorial duhet të vazhdojë me hapa të përshpejtuar, ndonëse qeveria është duke punuar për këtë, duke krijuar dhe ngritur grupe pune për të punuar shpejt. Z. Jaka propozoi që edhe Këshilli i Investimeve mund të ndërhyjë duke ngritur grupe të përbashkëta pune apo të marrë pjesë në grupe ndër-ministrorë në menaxhimin territorial dhe zhvillimin rajonal. Ekzistojnë vërtet disa projekte turistike, por duhet patur kujdes dhe të dimë pasojat e këtyre projekteve si në punësim ashtu edhe në ekonomi. Është e nevojshme të investohet gjithashtu në industri, agro-përpunim, bujqësi dhe sektorë të tjerë të bujqësisë dhe agro-turizmit. Qeveria duhet të ecë më shpejt, dhe të miratojë rekomandimet e Këshillit të Investimeve duke mbështetur sipërmarrjen private dhe duke siguruar lirinë në të bërin biznes. Z. Jaka theksoi shqetësimin e tij mbi kapacitetet e AIDA-s për të përmbushur detyrimet e reja dhe rolin e përcaktuar në ligjin strategjik. Ai theksoi mbështetjen për t'iu ofruar AIDA-s por gjithashtu edhe nevojën për të rritur financimet dhe kapitalin njerëzor të institucioneve për t'i bërë ato sa më të besueshme tek komuniteti i biznesit.

Kryetarja e Këshillit, iu përgjigj shumë prej çështjeve të ngritura nga pjesëmarrësit. Kryetarja Ekonomi informoi Këshillin se Ministria e Ekonomisë është duke mbajtur diskutime të vazhdueshme me Ministrinë e Mjedisit, si një shtysë e vazhdueshme nga bizneset në sektorin e riciklimit të mbetjeve, për rishikimin e Ligjit për Importin e Mbetjeve.

Në lidhje me Reformën në Drejtësi, kjo është një përparësi e Qeverisë por nevojitet një konsensus më i gjerë nga aktorët e politikës. Qeveria është duke konsideruar disa zgjidhje alternative. Reforma në Drejtësi është një çështje madhore dhe nuk varet vetem nga vullneti i mirë i Qeverisë, por gjithashtu edhe nga vullneti i mirë i forcave

politike në vend. Pavarësisht kësaj, Kryetarja shprehu bindjen e saj që biznesi duhet të lehtësohet. Për këtë arsye, pavarësisht kësaj Reforme, duhet të gjenden disa alternativa për të lehtësuar klimin e biznesit kur ka konflikte për t'u trajtuar.

Ka presion që Qeveria të lëvizë më shpejt dhe t'i përgjigjet nevojave të biznesit, por mekanizmi burokratik e ka paksa të vështirë t'i përshtat në kohë sfidave të biznesit. Megjithatë, ka një mirëkuptim të ndërsjellë nga Qeveria mbi nevojën për të lehtësuar procedurat dhe burokracinë për sektorin privat. AIDA është duke iu nënshtruar një ristrukturimi për t'iu përshtatur rolit të saj të ri si një dritare e vetme për investitorët, dhe po mbështetet nëpërmjet një asistence teknike, ligjore dhe financiare për të përmbushur kompetencat e zgjeruara. Menjëherë sapo AIDA të ketë përfunduar detyrat e kërkuara, mund të diskutohen ndryshime në statusin e saj. Gjithashtu, në lidhje me përfitimet e vendit nga Projekti TAP, Ministria përmendi përpjekjet aktuale me Ministrinë e Energjisë për përgatitjen e një Master Plan për Gazin në Shqipërinë. Në përfundim, ajo i kërkoi Sekretariatit mbështetje për organizimin e mbledhjeve konsultative të fokusuara në thjeshtimin e procedurave.

- Znj. Lindita Legisi, OMEGA, përgëzoi Sekretariatit mbi analizën krahasuese për incentivat e investimeve. Sektori i veshmbathjes (prit-dhe-shkurto) në veçanti ka rëndësinë e tij në strukturën e eksporteve. Për momentin situata është e qendrueshme, por Shqipëria mesa duket nuk është më tërheqëse se vendet e rajonit. Kompani të huaja me emër kanë treguar shumë interes për të punuar në Shqipëri, por mesa duket ato kanë zgjedhur të punojnë në rajon. Shqetësimet e sektorit i janë paraqitur edhe Qeverisë gjatë fazës së hartimit të paketës për sektorin “façon” dhe nevojitet që të rishikohen dhe zbatohen. Ndonëse qëllimi është të tërhiqen investime të reja, është e rëndësishme të konsiderohen gjithashtu nevojat e investitorëve aktualë të cilët kanë operuar në vend prej vitesh.
- Znj. Elvis Sulko, Banka Botërore, komplimentoi Sekretariatit mbi rekomandimet konkrete të paraqitura gjatë një viti punë. Është e nevojshme që tani Qeveria të fokusohet në zbatimin e tyre. Znj. Sulko sugjeroi që analiza nuk mjafton të jetë e krahasueshme me vende të rajonit por edhe largpamëse mbi nivelin e kërkuar të IHD-ve dhe eksporteve për të arritur potencialet ekonomike sikurse edhe rritjen e qendrueshme ekonomike. Cilësia e administratës publike është një fakt përmendur gjithashtu në shumë raporte ndërkombëtare dhe këtë herë vjen nga biznesi i përkthyer si burokraci. Administrata publike është duke punuar me staf të ulët dhe duhet të fokusohet të tërheqë të rinj të talentuar në treg. Një nga shqetësimet kryesore të biznesit janë cilesitet e aftësive në veçanti në industritë me punë intensive të cilat duhet të trajtohen në mënyrë të veçantë. Gjithashtu, Znj. Sulko përmendi asistencën e Bankës Botërore në lidhje me institucionet publike që kanë të bëjnë me përmirësimin e klimës së investimeve në vend.
- Znj. Laura Qorlaze, IFC, komplimentoi për analizën e thellë. Sugjeroi që AIDA të ketë në fokus gjithashtu investitorët strategjikë vendas të cilët mund të kenë ide, dhe t'i ndihmojë ata në orientim të investimeve. Ekonomia Shqiptare është duke kaluar një

fazë me investime të gabuara në sektorë të mbiinvestuar. Znj. Qorlaze sugjeroi që AIDA, në rast se nuk e kanë bërë ende, të aplikojnë indeksin e “kënaqësisë” së biznesit për analiza të mëtejshme. U ngrit gjithashtu nevoja për të ndryshuar mentalitetin e nëpunësve civilë në administratën publike për t’u konsideruar në shërbim të sektorit privat. Është e nevojshme që të ndërhyhet në këtë drejtim pasi një administratë e shëndetshme do t’i shërbente një ekonomie të shëndetshme.

IV. Aprovimi i Rekomandimeve

Kryetarja e Këshillit pyeti anëtarët nëse ata ishin dakord me rekomandimet e parashtruara për miratimin dhe për t’u përfshirë në planin e punës monitoruese të Sekretariatit. Të gjitha rekomandimet u miratuan. Sekretariati do të njoftojë në ditët në vazhdim temën për mbledhjen e ardhshme.

V. Mbyllja e Mbledhjes

Mbledhja u konsiderua e mbyllur në orën 19:00. Mbledhja e ardhshme do të mbahet më 29 qershor 2016.

Lista e Pjesëmarrjes

Përfaqësues nga Qeveria

1. Znj. Milva Ekonomi, Kryetar i Këshillit të Investimeve/Ministër i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes
2. Znj. Natasha Ahmetaj, Zëvendës Guvernatore e Bankës së Shqipërisë, në mungesë të Z. Gent Sejko, Guvernator i Bankës së Shqipërisë
3. Znj. Ermonela Felaj, Ministër i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin
4. Z. Genti Beqiri, Drejtor Ekzekutiv i AIDA-s
5. Z. Xhavit Curri, Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Tatimeve, në mungesë të Znj. Brisida Shehaj Drejtoreshë e Përgjithshme e Tatimeve
6. Znj. Arjana Dymishi, Këshilltare e Drejtoreshës së Përgjithshme të Doganave, në mungesë të Znj. Pranvera Behushi (Fagu), Drejtoreshë e Përgjithshme e Doganave.

Partnerë Ndërkombëtarë

1. Z. Yngve Engstroem, Shef i Bashkëpunimit pranë Delegacionit të BE në Shqipëri
2. Z. Christoph Denk, Shef i Zyrës së BERZH-it në Shqipëri
3. Znj. Evis Sulko, në mungesë të Znj. Tahseen Sayed, Drejtoreshë e Zyrës së Bankës Botërore në Shqipëri
4. Znj. Laura Qorlaze, Përfaqësuese e Zyrës së IFC në Tiranë

Komuniteti i Biznesit

1. Z. Nikolin Jaka, Kryetar i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë, Tiranë
2. Z. Silvio Pedrazzi, President i FIAA
3. Z. Gazmend Kadriu, Zv/Kryetar i Bordit Drejtues të AAB dhe Drejtor Ekzekutiv i Union Bank, në mungesë të Z. Christian Canacaris, Kryetar i Shoqatës së Bankave në Shqipëri
4. Z. Luan Muça, President i Delta Group
5. Znj. Lindita Legisi, Presidente e Omega shpk
6. Z. Dritan Nako, Drejtues i Departamentit të Administratës dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në mungesë të Z. Adamantios Frantzis, Drejtor i Përgjithshëm i TITAN ANTEA CEMENT

Nuk morën pjesë:

1. Z. Bledi Çuçi, Ministër i Shtetit për Çështjet Vendore/Koordinator Kombëtar i Strategjisë kundër Korrupsionit